

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Agim Kuçi, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtores Profesionale Luljeta Gashi Metaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit E.K., për shkak të veprave penale Ngacmimi nga neni 186 par.2 e lidhur me par.1, të KPRK-së, dhe veprën penale Shkelja e Urdhrit Mbrojtës të nga neni 25 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me shenjën PP.II.nr.8285/2014 të datës 03.07.2015, të cilën e përfaqësonte Prokurorja e Shtetit, Arbresha Shala, dhe në praninë e të pandehurit pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, me datë,4.4.2018, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa, me datën, 30.04.2018, e përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari E.K., nga babai H. dhe nëna Z., mbiemri i vajzërisë H., i lindur me datë ..., në fshatin K., me vendbanim në F.K., blloku ... hyrja ..., kati- ..., nr...., ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i pesë(...) femijëve, punon në a.s., i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse,

Me datë 27.11.2014, në orët e pasditës, në P., para Ambulancës P. Gj., në Lagjen U., i pandehuri me një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ka komunikuar me qëllim të ngacmimit dhe frikësimit me të dëmtuarën A.P., derisa ajo ka qenë në orarin e punës para ordinancës duke pirë duhan, ashtu që i është ofruar asaj dhe me zë të lartë i ka thënë „kam me të kallë me benzin ty dhe ordinancën edhe këtu në P. por edhe ordinancën në O.”, dhe gjatë këtyre veprimeve e ka vënë të dëmtuarën nën shqetësim të madh emocional dhe i ka shkaktuar ndjenjën e frikës, rrezikshmerinë personale dhe cenimin e dinjitetit, si dhe i pandehuri ka shkel pjesërishtë urdhrin për mbrojtje të dhënë me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë,C.nr. 1114/14 të datës 17.04.2014, në të cilin të pandehurit i ndaluar kryerja apo kërcënimi i ndonjë veprë penale të dhunës ndaj palës së mbrojtur-A.P., që të mos e trazoi, ngacmoi dhe të mos kontaktoj apo të komunikoj me palën e mbrojtur, duke përfshirë edhe vendin e punës private në Lagjen U., në Ambulancën P. Gj. në P., në distancë prej 50 m, në afatin prej dymbëdhjetë (12) muajve nga dita e lëshimit të urdhrit mbrojtës,

me këtë ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 186, par.2, lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe

veprën penale Shkelja e Urdhrit Mbrojtës të nga neni 25 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Andaj, gjyqtari i vetëm, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 41, 42, 43,46, 73 dhe 80 të KPRK-së, si dhe neneve 248 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit i:

P Ë R C A K T O N

- I. Për veprën e parë penale për të cilën akuzohet i njëjti shpallet fajtor dhe i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro.
- II. Për veprën penale të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 300 (treqind) euro.

Në kuptim të nenit 80 të KPRK-së, gjykata e gjykon me :

DËNIM UNIK ME KUSHT

Pas pranimit të fajësisë i akuzuarit E.K., për veprat penale, për të cilat akuzohet i shqipton dënim me kusht-dënim me gjobë në shumën prej 700 euro i cili dënim nuk do të ekzekutohet gjatë periudhës verifikuese prej një (1) viti nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, nëse nuk kryen vepër të re penale.

- Obligohet i akuzuari që të paguaj në emër të shpenzimeve procedurale aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, për kompenzimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro, dhe për paushallin gjyqësor 30 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përbarimit me detyrim.

E dëmtuara A.P. nga fshati K., Komuna e O., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës

Prokuroria Themelore në Prishtinë—Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën me shenjen PP.II.nr.8285/2014 të datës 03.07.2015, ndaj të pandehurit E.K. me vendbanim në F.K. blloku ... hyrja -..., kati..., nr...., për shkak të veprave penale: Ngacmimi nga nenin 186, par. 2 e lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale Shkelja e Urdhrit Mbrojtës të nga neni 25 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 15.06.2017, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri E.K. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet, dhe në shqyrtimin kryesor të datës 04.04.2018 duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprave penale.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin kryesor dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike se: Pas shikimit të shkresave të lëndës gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit E.K., formesohen të gjitha elementet

e veprës penale, për të cilën akuzohet i pandehuri, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Tiparet qenësore (figura) të veprave penale

Në nenin 186 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Ngacmim e kryen.

1.Kur vepra penale nga paragrafi 1. I këtij neni kryhet ndaj personi me të cilin kryesi ka qenë apo është në marrëdhënie familjare ose ndaj një ish anëtari apo anëtari aktual të familjes, kryesi dënohet me burgim prej, gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që përfshihet në sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padeshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjessë personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmëve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit. Frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrases së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes të afërmëve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

3. Neni 25, Ligji për Mbrojtjen nga dhuna në familje, Nr. 03/L-182, përcakton: Kush e shkel në tërësi ose pjesërisht urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjent kryen veprë penale që dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro deri më dymijë (2000) euro ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues ka vendosur që të pandehurin E.K. t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit (Individualizimi i dënimit)

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata e ka marrë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit; se është përdorur për kryerjen e këtyre veprave penale; se me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë veprë tjetër penale. Ndërsa, gjyqtari i çështjes, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të pandehurin.

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues, dënimi me burgim dhe me gjobë ndaj të pandehurit A.H., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtari i çështjes, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPPRK-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të behet i formës se prerë.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 3, të KPPK, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i përgjithshëm-Penal

P.nr.2393/2015, të dt:30.04.2018

Bashkëpunetore Profesionale

Luljeta Gashi-Metaj

Gjyqtar

Agim Kuçi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.